



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. LM /001/2018

Datë: 10.01.2018

Në mbështetje të nenit 28, 34, 35, 36, 38 dhe 54, paragrafi (2) nën paragrafin 2.1, i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare nr.88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, tutje ref. Autoriteti duke pasur parasysh kërkesën e Telekomit të Kosovës, SH.A me nr.te regjistrimit në ARBK 70280741 me seli ne Prishtinë - Dardania p.n, me Nr.Prot.298/15-01 Datë:10.03.2017, të bëjë vlerësimin ex-post të objektit të *Marrëveshjes Ekskluzive* e lidhur ndërmjet operatorëve ekonomik Ipko Komunikimet me Digit Alb, SH.A në mënyrë që të analizohet nëse ka ndikim mbi konkurrencën në treg, andaj Komisioni i AKK-së në mbledhjen e mbajtur me datën, 10.01.2018 merr këtë:

KONKLUZION

për

- I. Fillimin e procedurës hetimore ndaj IPKO Komunikimet, me adresë Lagja Ulpianë, Zija Shemsiu Nr.34, Prishtinë dhe Digit Alb SH.A - Shoqëri Aksionare, e cila përbehet nga Televizioni privat “Top Channel” me seli në Tiranë dhe me filialen në Prishtinë me adresë Rr. Luan Haradinaj nr.15/7 Prishtinë, Nr. regjistrimit te biznesit: 70501899 Kosovë,dhe Digit Alb SH.A- Dega Kosovë – Prishtinë, adresa Rr.Luan Hradinaj, Pllati i Rinisë p.n, me Nr. regjistrimi 70906082, lidhur me *Marrëveshjen Ekskluzive* për shitje dhe distribumin e pakove televizive të prodhuesit “Digit Alb SH.A për tregun e Republikës së Kosovës.
- II. Autoriteti, kërkon nga Ipko Komunikimet dhe Digit Alb, SH.A, që t’i ofrojë të gjitha informatat e nevojshme (*Marrëveshjen Ekskluzive – Kontratën*) dhe të gjitha dokumentet e nevojshme për vlerësim.
- III. Pala është e detyruar që në afat prej **10 ditësh** të i’a ofroj Autoritetit dokumentet e kërkuara si në pikën II (DY) të këtij dispozitivi.
- IV. Ky konkluzion hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni.

ARSYETIM

Autoriteti është kompetent për marrjen e iniciativës për fillimin e procedurës sipas detyrës zyrtare, bazuar në kërkesat, propozimin, kundërshtimin ose ndonjë paraqitje tjetër në formë të shkruar. Parashtruesi I kërkesës pretendon se kontrata-marrëveshja ekskluzive, parandalon, kufizon dhe keqpërdorë konkurrencën në dëm të subjekteve tjera të cilat veprojnë në tregun e telekomunikimeve në territorin e Republikës së Kosovës.

Pretendimet janë se kjo kontratë ka tipare të marrëveshjeve të ndaluara nga neni 4 të Ligjit 03-L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke pamundësuar konkurrencën në mes të operatorëve legal të licencuar në tregun përkatës, vlen të theksohet se parashtruesi i kërkesës pretendon po ashtu edhe shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve 2004/17 për dëmtim të konsumatorëve të Republikës së Kosovës nga qasja konkurruese për këto produkte shitje dhe distribuimin e pakove televizive të prodhuesit “Digit Alb Sh.A. për tregun e Republikës së Kosovës.

Përshkrimi i rrethanave të rastit/gjendjes faktike, nga parashtruesi i kërkesës :

- Ipko dhe Digit - Alb SH.A për me tepër se 13 vite kanë të nënshkruar kontratë ekskluzive me të cilën Ipko është distributor ekskluzive i produkteve të kompanisë Digit–Alb SH.A, duke mos lejuar që asnjë operator tjetër i licencuar të ketë qasje në paketën e programeve Digit Alb, duke krijuar monopol në tregun përkatës dhe dëmtuar konkurrencën e lirë dhe të garantuar në treg.
- Telekom i Kosovës, i cili posedon infrastrukturën më të zhvilluar të rrjetit të telekomunikimeve është përjashtuar nga gara e produkteve televizive.
- Telekom i Kosovës është refuzuar nga prodhuesi Digit- Alb për mundësin e blerjes për shkak të klauzolave kundërligjore për të kontratës me Ipko-n
- Kontrata ekskluzive komerciale është konfidenciale dhe nuk është e publikuar përveçse zyrtarisht janë deklaruar se Ipko është distributor ekskluziv i Digit Alb-it.
- Parashtruesi i kërkesës, kërkon nga AKK që të vlerësoj nëse marrëveshja në fjalë bie nën zbatimin e nenit 5,6 dhe 7 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të vlerësohen të gjitha elementet e konkurrencës dhe efekti i Marrëveshjes Ekskluzive në tregun e Kosovës .
- Po ashtu parashtruesi i kërkesës konsideron se, nëse kjo marrëveshje ka elemente që mund të konsiderohen të ndaluara sipas nenit 4 atëherë bazuar në nenin 9, kjo kompani duhet të kërkojë nga AKK përjashtim sipas neneve 5,6,7 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pas aplikimit për përjashtim Autoriteti do ta shqyrtojë aplikimin dhe do të hetojë çështjen e parashtruar në aplikim. Bazuar në nenin 9 të Ligjit sipas paraqitësit të iniciativës IPKO është dashtë të aplikojë tek Autoriteti për përjashtim sipas nenit 4 të Ligjit dhe se Autoriteti përcakton periudhën kohore gjatë të cilës përjashtimi mbetet në fuqi po jo më shumë se tre (3) vite.
- Paraqitësi i kërkesës pretendon se palët në marrëveshje nuk e kanë kryer detyrimin për përjashtim në Autoritet, e kjo sipas tyre paraqet shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës
- Paraqitësi i iniciativës pretendon se IPKO ka pozitë dominuese në tregun përkatës sipas nenit 10 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës
- Ndër tjera, paraqitësi i iniciativës kërkon nga Autoriteti që të vlerëson nëse ekziston Abuzimi me Pozitën Dominuese.
- Paraqitësi i iniciativës kërkon që , Autoriteti konform dispozitave të Ligjit të hulumtojë në detaje dispozitat e kontratës komerciale ndërmjet Ipko dhe Digit ALB e që sipas tyre kjo kontratë ka tiparët e marrëveshjes së ndaluar nga neni 4 dhe abuzim me pozitën dominuese nga neni 11 i Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës .
- Gjithashtu në kërkesë pala ankuese kërkon që marrëveshja komerciale Ipko-Digit ALB **te konsiderohet e pavlefshme** dhe të obligohet Digit-ALB, që pas përjashtimit të dispozitave të ekskluzivitetit të mundësohet pa pengesa dhe ndalesa që edhe operatorit

Telekomi i Kosovës, që në kushte komerciale të kenë qasje në produktet e saj për distribuimin në tregun përkatës të Republikës së Kosovës .

Nga vlerësimi i dokumentacionit të ofruar nga paraqitësi i kërkesës paraprakisht shprehim se marrëveshja në fjalë sipas pretendimeve të paraqitesit të kërkesës, aludohet se ka si **objekt** dhe **pasojë** disa kufizime të konkurrencës, ndërsa për t'i sqaruar të gjitha këto pretendime Autoriteti duhet, që të sigurojë dhe të konsultojë klauzolat e Marrëveshjes Ekskluzive, të atakuar.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës nuk është e lejuar ankesa dhe nuk është e lejuar padia për iniciimin e konfliktit administrativ.

(_____
Valon Prestreshi
Kryetari i AKK-së

(_____) (_____) (_____) (_____)
Ahmet KRASNIQI Fatime S. HAZIRI Muhamed KRASNIQI Shaqir MORINA
Zv. Kryetar Anëtare Anëtar Anëtar

Me këtë Konkluzion te njoftohen:

- *Ipko Komunikimet*
- *Digit - ALB - Prishtinë*
- *Arkiva*